

## MENDIM NË PAKICE

Mbi votimin “KUNDËR” ndaj qëndrimit të shumicës, në lidhje me Vendimin nr. 243, datë 29.10.2019, në përgjigje të kërkesës drejtuar Këshillit të Lartë Gjyqësor, nga z. {...}, në lidhje me ekzekutimin e Vendimit nr. {...}, datë {...} të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, lënë në fuqi me vendimin nr. {...}, datë {...}, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

Në Mbledhjen Plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, datë 29.10.2019 (ditë e martë), në pikën e dytë të rendit të ditës, është përfshirë për shqyrtim në këtë mbledhje edhe shkresë/kërkesa e përsëritur e z. {...} e depozituar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i cili ka kërkuar detyrimin e institucioni të shprehet në lidhje me “*Detyrimin e palës së Paditur, Këshilli i Lartë i Drejtësisë të marrë në shqyrtim kërkesën e paraqitur nga z. {...} depozituar në datë 18.2.2013*”, si dhe gjithashtu të shprehet në lidhje me statusin e gjyqtarit z.{...}.

Për sa më sipër, nisur nga fakti që kemi mbajtur qëndrim të kundërt me shumicën e anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe bazuar në nenin 66 pikën 9, të ligjit 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit Të Drejtësisë”...

### Thirrja e mbledhjes plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor...

...9. Në rastet kur Këshilli merr vendime administrative individuale në lidhje me statusin profesional të gjyqtarëve të veçantë ose të zyrtarëve të veçantë të administratës gjyqësore, **anëtari i mbetur në pakicë mund të kërkojë që opinioni i tij t’i bashkëngjitet vendimit të Këshillit.** Në këtë rast, anëtari është përgjegjës për hartimin dhe dorëzimin e opinionit të pakicës brenda afatit të caktuar nga Këshilli për zbardhjen e vendimit..., parashtrijmë sa më poshtë argumentet tona, në lidhje me këtë çështje:

- Për sa i përket aspektit formal procedural më duhet të theksoj se;

**Së pari:** Këshilli i Lartë Gjyqësor pas administrimit të kërkesës së z.{...}, konstatoi faktin se:

**ish- Këshilli i Lartë i Drejtësisë, bazuar në nenin 1 të ligjit nr. 8811, datë 17.5.2001, “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, ishte “...autoriteti shtetëror përgjegjës për mbrojtjen, emërimin, transferimin, shkarkimin, edukimin, vlerësimin moral e profesional, karrierën, dhe për kontrollin e veprimtarisë së gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë dhe të gjykatave të apelit”,**

gjithashtu kishte detyra funksionale, bazuar në nenin 2, të ligjit të sipërpërmendur:

- a) “I propozon Presidentit të Republikës emërimin e gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë dhe të gjykatave të apelit.

b) **Vendos për shkarkimin e gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë dhe të gjykatave të apelit.**

c) Vendos për transferimin e gjyqtarëve.

ç) Vendos për marrjen e masave disiplinore ndaj gjyqtarëve.

d) Kujdeset për kualifikimin e gjyqtarëve.

dh) Vendos kriteret për vlerësimin e gjyqtarëve, kontrollon dhe garanton procesin e vlerësimit dhe shqyrton ankimet e gjyqtarëve për vlerësimin e tyre.

e) Emëron dhe shkarkon, kryetarët dhe zëvendëskryetarët e gjykatave të shkallës së parë dhe të gjykatave të apelit.

ë) Emëron dhe shkarkon inspektorët e Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

f) Kryen detyra të tjera të përcaktuara në ligj.”,

Këto detyra dhe kompetenca ish Këshillit të Lartë të Drejtësisë nuk i ushtroi pasi nuk shqyrtoi asnjëherë çështjen e z. {...}, nga data 18.02.2013 kur rezulton të jetë paraqitur kërkesa e parë e tij deri në pushimin e funksioneve të këtij Këshilli më datë 12.12.2018, për shkak të konstituimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky fakt rezulton nga kërkesat e përsëritura të z. {...}, drejtuar ish Këshillit të Lartë të Drejtësisë, gjendur në arkivin e trashëguar të këtij institucioni nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Gjithashtu, bazuar në vendimin nr. {...}, datë {...} të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, lënë në fuqi me vendimin nr. {...}, datë {...}, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, përcaktohej detyrimi i ish- Këshillit të Lartë të Drejtësisë për të ushtruar kompetencat e dhëna me ligjin 8811, datë 17.5.2001, për t'u shprehur në lidhje me kërkesën e përsëritur të z. {...}, **për rikthim në funksionin e gjyqtarit**, veprim të cilin ky Këshill nuk e kreu, pasi kërkesat e z. {...} nuk u paraqitën në asnjë Rend Dite të Mbledhjes Plenare të ish Këshillit të Lartë të Drejtësisë për shqyrtim, dhe rrjedhimisht nuk u mor asnjë vendim në lidhje me kërkesën e tij.

Me mosveprimin për shprehjen e vullnetit nga ana e ish Këshillit të Lartë të Drejtësisë me një vendim qoftë pozitiv ose negativ, z. {...} **iu mohua një e drejtë themelore, ajo e ankimit**, pasi po t'i referohemi nenit 34, të ligjit 8811, datë 17.5.2001, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, shprehet se;

#### **Procedurat e ankimit**

1. Ankimi ndaj vendimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë për shkarkimin nga detyra e gjyqtarit, bëhet nga ky i fundit në Gjykatën e Lartë brenda 10 ditëve nga marrja e njoftimit për vendimin e këtij Këshilli....

Gjendur përpara këtyre fakteve dhe vendimit të formës së prerë nr. {...}, datë {...}, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, **Këshilli i Lartë Gjyqësor si institucion kompetent** bazuar në ligjin nr. 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, neni 61,

“2. Këshilli i Lartë Gjyqësor në mbledhjen plenare ushtron kompetencat e mëposhtme:

a) emëron, vlerëson, ngre në detyrë dhe transferon gjyqtarët e të gjitha niveleve;

b) vendos masa disiplinore ndaj gjyqtarëve të gjitha niveleve;....”

**ka detyrimin ligjor për t'u shprehur ndaj kërkesës së z.{...}**, por duke iu referuar ligjit të kohës, në momentin kur vendimi i formës së prerë nr. {...}, datë {...}, i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, detyronte ish Këshillin e Lartë të Drejtësisë të shprehej me vendim, në lidhje me rikthimin ose jo të z.{...} në funksionin e gjyqtarit.

**Së dyti :** Bazuar në sa më sipër, Këshilli i Lartë Gjyqësor duhet të kishte parasysh se arsyetimi mbi të cilin duhet të gjykonte kërkesën e z.{...}, do të ishte **ligji nr.9877, datë 18.2.2008, “Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”**, nenin 20 të të cilit parashikohet se :

*Palëvizshmëria e gjyqtarit.*

*Gjyqtari nuk mund të lëvizë nga detyra, përveç rasteve kur:*

*a) jep dorëheqjen;*

*b) mbush moshën 65 vjeç, të daljes në pension;*

***c) dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi;***

*ç) shkarkohet nga detyra.*

**Duke parashtruar rrethanat e çështjes në shqyrtim**, z.{...} është emëruar nga gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me pëlqimin e tij dhe me pëlqimin e dhënë nga ish Këshilli i Lartë Drejtësisë, nëpërmjet Vendimit nr. {...}, datë {...}, pika 2, në të cilin përcaktohet se Këshilli “...Pasi shqyrtoji Kërkesën e Ministrit të Drejtësisë, në lidhje me shërbimin pranë strukturave të Ministrit të Drejtësisë, të gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, z. {...}, si dhe ruajtjes për këtë gjyqtar, të statusit të gjyqtarit, duke marrë parasysh edhe pëlqimin e dhënë nga z.{...}, në përfundim vendosi ta pranojë këtë kërkesë.”

Bazuar në vendimin e sipërpërmendur dhe në nenin 28, të ligji nr.9877, datë 18.2.2008, “Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, ku parashikohet;

*“Ruajtja e statusit të gjyqtarëve që shërbejnë në institucione të tjera”*

*1. Gjyqtarët, me kërkesën e institucioneve e pëlqimin e tyre, si dhe me vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, mund të shërbejnë për një afat deri në 3 vjet në strukturat e Ministrisë së Drejtësisë, të administratës së Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ndihmës ligjor ose këshilltar i gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, të Gjykatës së Lartë dhe të gjykatës së apelit, prokuror, pedagog ose drejtor në Shkollën e Magjistraturës. Në përfundim të këtij afati, gjyqtarët kthehen në vendin e mëparshëm të punës.*

Z.{...} emërohet me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. {...}, **datë {...}{...}** dhe **shkarkohet** po me Vendim të Këshillit të Ministrave nga kjo detyrë, me **vendimin nr. {...}, datë {...}**.

Përpara **kësaj procedure shkarkimi, në datë 22.9.2008**, oficeri i policisë gjyqësore pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka referuar informacion për veprën penale, mbi bazë të cilit është regjistruar procedim penal nr. {...}, të vitit 2008, kundër {...}, z.{...}, me akuzën e **“Shpërdorimit të detyrës kryer në bashkëpunim”**, parashikuar nga neni 248-25 i Kodit Penal.

Duke iu referuar fakteve dhe kronologjisë së tyre, nuk mund të mendohet që akuza e ngritur ndaj z. {...} si {...}-së, nuk do të ndikonte dhe pas sillte shkarkimin e tij nga detyra, siç dhe ndodhi me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. {...}, datë {...}.

Vërtet çështja e ngritur për z. {...} nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë ishte për një rast konkret të lidhur me vendimmarrjen e tij si {...}, por dhe shkarkimi nga detyra gjatë kohës së procedimit penal të ngritur kundër tij për veprën penale të ***“Shpërdorimit të detyrës kryer në bashkëpunim”*** kishte lidhje me funksionet që ushtronte në mënyrë të drejtpërdrejtë në institucionin që drejtonte në atë kohë.

Z. {...} ndodhur përpara faktit, të shkarkimit nga detyra dhe procedimit penal, si {...}, duhej të provonte me çdo kusht pafajësinë e tij, pasi parashikimi i nenit 20 shkronja “c” të ligjit nr.9877, datë 18.2.2008, shprehimisht përcakton nëse gjyqtari ***dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi***, përbënte shkak pengues për të kryer detyrën e gjyqtarit.

Gjithashtu po t’i referohemi nenit 29 të ligjit të sipërpërmendur, “Përgjegjësia penale e gjyqtarit”, pika 1 parashikon se: ***“Gjyqtari i gjykatës së shkallës së parë ose gjyqtari i gjykatës së apelit mund të ndiqet penalisht, sipas dispozitave të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale. Autorizimi për fillimin e procedimit penal bëhet me miratimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë.”***

Në rastin konkret është organi kompetent, pra Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë që ka filluar veprime hetimore duke mos respektuar rregullat procedurale për kryerjen e hetimeve sipas ligjit dhe iniciuar në mënyrë të ligjshme procesin penal ndaj z. {...}, i cili e gëzonte statusin e gjyqtarit.

Në këtë rast nuk mundet në asnjë mënyrë të konsiderohet faji i subjektit për veprimet apo mosveprimet e kryera nga organi që kryen hetimin ndaj subjektit të procedimit penal. Gjithashtu ky fakt nuk mund të përdoret si dëshirë e shprehur në heshtje e z. {...} për heqjen dorë nga statusi i gjyqtarit dhe njëkohësisht mbarimin e statusit.

Po në nenin 29 të ligjit nr.9877, datë 18.2.2008, pika 4, përcaktohet; ***“Në rastet kur fajësia nuk provohet me vendim gjyqësor të formës së prerë të gjykatës, gjyqtari ka të drejtë të kthehet në punën e tij të mëparshme dhe të marrë pagën e plotë që nga koha e pezullimit.”***

Bazuar në sa më sipër, z. {...} me vendimin nr. {...}, 7 {...}, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë “Deklarim i pafajshëm i të pandehurit {...}” dhe me vendimin nr. {...}, ***datë {...}*** të Gjykatës së Apelit Tiranë, “Lënie në fuqi të vendimit nr. {...}, {...}, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”, ***me të drejtë i drejtohet zyrtarisht me shkresë datë 18.2.2013*** ish Këshillit të Lartë të Drejtësisë për rikthimin në pozicionin e tij të mëparshëm të gjyqtarit, pasi kishte arritur të provonte pafajësinë me vendim të formës së prerë.

Nga veprimet e njëpasnjëshme të ndërmarra nga z. {...}, nuk mund të mendohet se në heshtje është kërkuar dorëheqje nga statusi i gjyqtarit dhe për më tepër nuk mund të pretendohet që e

drejta për t'u rikthyer në pozicionin e mëparshëm të gjyqtarit është parashkruar, për sa kohë nuk e kërkoi brenda tre vjetëve të lejes së dhënë nga ish Këshilli i Lartë Gjyqësor, pasi vetë vendimi i Gjykatës Administrative i ka dhënë përgjigje dhe e ka zgjidhur këtë fakt duke e detyruar ish Këshillin e Lartë të Drejtësisë të shprehet me vendim. Referuar nenit 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pika "...3. Organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore."

Gjithashtu nuk mund të interpretohet dhe referohet në konkluzionet që çojnë Këshillin e Lartë Gjyqësor të marrë vendim mbi kërkesën e z. {...}, për t'u rikthyer në pozicionin e gjyqtarit duke u mbështetur në pikën ç, neni 20, i ligjit nr.9877, datë 18.2.2008, "Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë" në të cilin parashikohet si shkak për mbarimin e statusit të gjyqtarit, ndër të tjera, **shkarkimi nga detyra.**

Ky shkak për mbarimin e statusit të gjyqtarit, i referohet marrjes të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra funksionale si gjyqtar, në referim të nenit 32 pika 2 të Ligjit nr. 9877, datë 18.2.2008, konkretisht në nenin 32 pika 2 parashikohet se:

2. Janë shkelje shumë të rënda aktet dhe sjelljet që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit si më poshtë:

a) aktet dhe sjelljet e ndaluara nga neni 23 i këtij ligji;

b) braktisja e punës ose mungesa e pajustificuar dhe e vijueshme për 7 ditë ose më shumë, kur mungesa ka passjellë pasoja për të drejtat kushtetuese të palëve në gjykim apo për dhënien e drejtësisë;

c) shkelja e pajustificuar dhe e përsëritur e dispozitave urdhëruese procedurale, kur këto shkelje kanë passjellë ose mund të sillnin pasoja për të drejtat kushtetuese të palëve në gjykim apo për dhënien e drejtësisë;

ç) refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive; d) përfitimi në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë i dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale, të cilat i jepen për shkak të detyrës;

dh) mos bërja e kërkesës për heqje dorë nga gjykimi, kur kjo është e detyrueshme, sipas Kodit të Procedurës Penale dhe Kodit të Procedurës Civile;

e) mungesa absolute e arsytimit në vendimin gjyqësor; ë) refuzimi i zbatimit të masës disiplinore;

f) moszbatimi i vendimit unifikues, si dhe i vendimeve të tjera të Gjykatës së Lartë, kur, sipas kodeve të procedurave, këto vendime janë të detyrueshme;

g) kryerja e një shkeljeje të rëndë, kur gjykatësi ka qenë më parë i dënuar për një shkelje tjetër të rëndë, e cila nuk është parashkruar ose shuar; gj) akte dhe sjellje të tjera të rënda që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit.

Nëse i referohemi secilit shkak të përcaktuar në nenin e sipërcituar, rezulton qartë se ato lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me ushtrimin e funksionit gjyqësor dhe jo të funksioneve të tjera të cilat ushtron gjyqtari në kohën që është komanduar në një institucion tjetër jo gjyqësor.

Masa disiplinore e shkarkimit nga detyra të z. {...} nuk rezulton te jetë marrë për asnjë nga rastet e parashikuara në këtë nen. Kjo masë, pavarësisht se sa është e bazuar ose jo, nuk i

referohet dhe nuk mund t'i referohet asnjërit nga shkaqet që ka parashikuar ligji i kohës të cilat lidhen ekskluzivisht dhe vetëm me ushtrimin e funksioneve gjyqësore nga gjyqtari.

Duke qenë se masa disiplinore ndaj tij nuk është marrë në kuadër të një procedimi disiplinor që ka lidhje me ushtrimin prej tij të funksioneve gjyqësore, nuk mund të interpretohet se termi “shkarkim nga detyra” si shkak për mbarimi të statusit parashikuar në nenin 20 shkronja “ç” përfshin çdo masë shkarkimi nga detyra që mund të merret nga çdo organ tjetër administrativ.

Kjo pasi “shkarkimi nga detyra” si shkak për mbarimin e statusit të gjyqtarit në referim të nenit 20 shkronja “ç” mund dhe duhet të interpretohet duke iu referuar përcaktimeve të Ligjit ne fuqi në kohën që ka ndodhur fakti i cili me “shkarkim nga detyra” nënkupton vetëm marrjen e masës disiplinore nga organi kompetent në përfundim të një procedimi disiplinor që zhvillohet për shkaqet ligjore të përcaktuara në nenin 32 pika 2 të ligjit.

Interpretimi i zgjeruar ose me analogji, i termit “shkarkim nga detyra” duke barazuar me të çdo masë shkarkimi të marrë nga organet e tjera administrative, përbën tejkalim të parashikimeve të ligjit dhe deformon qëllimin e tij. Nëse ligjvënësi do të kishte pasur qëllim përfshirjen në këtë term të çdo mase shkarkimi, të marrë edhe nga organet e tjera administrative, të ndryshme nga organi që zhvillon procedimin disiplinor të gjyqtarit, do të kishte parashikuar në nenin 32 pika 2 shkaqet respektive shtesë për të cilat do të njihje dhe masat disiplinore të marra nga organet e tjera, në të cilat gjyqtari ushtron detyrën si i komanduar.

Gjithashtu, bazuar në situatën konkrete të parashtruar më sipër, në asnjë rast nuk gjendet bazë ligjore referuar ligjit nr. 9877, datë 18.2.2008, “Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, mbi të cilin duhej gjykuar çështja në fjalë, se mos drejtimi me kërkesë pranë ish Këshillit të Lartë në Drejtësi, brenda tre viteve nga dhënia e lejes për të ushtruar detyrë jashtë sistemit gjyqësor, automatikisht mund të sillte humbjen e statusit të gjyqtarit {...}, pasi në çdo moment duhet të ishte bërë vlerësimi i rrethanave dhe i ngjarjes konkrete.

*Për këtë arsye mendojmë se Këshilli i Lartë Gjyqësor duhet të mbante një qëndrim të ndryshëm, nga ai i refuzimit të kthimit në funksionin të gjyqtarit {...}.*

Për sa më sipër, shprehim qëndrimin dhe argumentet tona dhe votuam “**KUNDËR**” propozimit për refuzimin e kërkesës së z. {...}, për kthim në funksionin e gjyqtarit.

**Zëvendëskryetar**  
**MAKSIM QOKU**

**Anëtar**  
**MEDI BICI**

**Anëtar**  
**ERJON MUHARREMAJ**

**Anëtar**  
**DRITAN HALLUNAJ**